

Syllabusi i lëndës

Lënda: **Sfidat Evropiane të Ligjit Islam**

Programi i studimit: Studime islame

Niveli: Master

Numri i ECTS kredive: 5

Lloji i lëndës: Zgjedhore

Kodi i lëndës:

Numri i orëve: 2+1

Semestri: I-rë

Profesori i lëndës: Prof. ass. dr. Shefqet Krasniqi

Përmbledhje e shkurtër e lëndës:

Lënda 'Sfidat Evropiane të Ligjit Islam' përfshin përkshkrimin e pakicave muslimane në përgjithësi, e të atyre në perëndim në veçanti, specifikat e tyre, sfidat e tyre. Lidhja e këtij fikhu me fikhun e përgjithshëm. Rëndësia e fikhut për pakicat muslimane në perëndim, përqendrimet e fikhut për ta, pastaj rregullat e përgjithshme të fikhut të cilat u kryejnë punë më shumë muslimanëve në ato vende. Pastaj mesele të ndryshme me të cilat sfidohen muslimanët atje në perëndim e për të cilat kanë nevojë për përgjigje.

Qëllimi i lëndës:

Qëllimi i kësaj lënde është të bëhet e qartë për studentët dhe nëpërmjet tyre edhe tek muslimanët se fikhu i pakicave muslimane që jetojnë nën hijën e shoqërive jo muslimane ndyrshon nga fikhu i përgjithshëm, respektivisht nga ata musliman që jetojnë si shumicë apo në vendët islame. Dhe se feja Islame është e përshtatshme edhe për ta, ashtu siç është e përshtatshme për çdo vend, çdo kohë dhe çdo shoqëri. Kjo fe nëpërmjet fikhut ju ofron zgjidhje atyre në çdo sfidë me të cilën ballafaqohen ata duke ua ruajtur atyre fenë po edhe dynjan. Respektivisht lidhjet e tyre me Zotin dhe raportet e tyre me njerëz. Nëpërmjet kësaj lënde ju ofrojmë muslimanve zgjidhje në shumë çështje me të cilat ata ballafaqohen thujse për çdo ditë.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Nëpërmjet kësaj lënde pritet që studenti të jetë më i aft, më i kujdesshëm në sjelljet e tij dhe sigurisht më i suksesshëm në fetvat e tij dhe qëndrimet e tij ndaj muslimanëve pakicë, ashtu sikurse që duhet të jetë më i kujdesshëm dhe më i suksesshëm edhe në raportet e tij dhe të muslimanëve karshi shoqërive tjera jo muslimane me të cilat jetojnë muslimanët. Krejt kjo për t'ia lehtësuar muslimanit

ruajtjen e fesë dhe të njejtën kohë edhe përfaqësimin e Islamit si fe me vlera të larta absolute nga e cila ka vetëm hair dhe dobi.

Metodologjia e mësimdhënies:

Përmbajtja dhe metodologjia e mësimdhënies do të jetë e standardeve të ligjëratave interaktive. Pra, gjatë ligjërimit, do të promovohet edhe metoda e debateve, diskutimeve akademike, e shprehjes së mendimit të lirë dhe kritik akademik nga ana e studentëve.

Përmbajtja e lëndës:

Java e I-rë:

Ligjërata hyrëse, njohja me përmbajtjen, objektivat akademike të lëndës, shpërndarja e plan-programit dhe zberthimi i metodologjisë së mësimdhënies

Java e II-të

Fikhu i pakicave myslimane/Definicioni i Fikhu en Nevazil (Pakicave myslimane)/Llojet e Nevazil/Rëndësia e Fikhut të pakicave

Java e III-të

Ripërtrirja e Fesë/Kuptimi i ripërtritjes së fesë/Synimet e ripërtrirjes/

Java e IV-të

Reformuesi (muxhedidi)/Ekzistimi i më shumë se një muxhedidi në një kohë/Ripërtrirja duhet të jetë në fenë e njerëzve dhe jo në vet fenë/Fushat e ripërtrirjes/

Java e V-të

Lëvizjet ripërtrirëse bashkëkohore/Ed-dave es selefije/Ed djubendije/Xhemati i hadithit/Xhemat Ensar Es Suneh El Muhamedije/El Ihvan El muslimin/El Xhemaatu el islamije

Java e VI-të

Lëvizjet ripërtrirëse bashkëkohore/Xhemaatu et teblig/Es senusije/Nurxhitë/Hareketu el itixhah el islamije (en nahdah)/Hizbu selameh el vatani (Refah partesi)/Fronti popullor në Sudan/Hamas, Palestinë/El xhebbetu el islamije lil inkadh, Algjeri/Muslimanët e rinj, Bosnjë/

Java e VII-të

Përqendrimet e fikhut të pakicave

Java e VIII-të

Kollekfiumi i I-rë

Java e IX-të

Rregullat e përgjithshme të fikhut/Rëndësia e rregullave të fikhut/Historiku i rregullave të fikhut/

Java e X-të

Ndarja e rregullave të fikhut

Java e XI-të

Rregullat e mëdha të fikhut (El Kavaid el kubra)/Çështjet janë sipas qëllimit/Bindja nuk anulohet me dyshim/Vështirësia tërheq lehtësimin/

Java e XII-të

Rregullat e mëdha të fikhut (El Kavaid el kubra)/ Dëmi largohet/Tradita duhet marrë parasysh/

Java e XIII-të

Disa rregulla të nevojshme për pakicat/Domosdoshmëria lejon të ndaluarën/Nevoja zbret në vend të domosdoshmërisë/Pasojat e veprave/Ndryshimi i fetvasë si shkak i ndryshimit të kohës, vendit dhe gjendjes/

Java e XIV-të

Disa çështje (mesele) bashkëkohore të nevojshme me të cilat sfidohen pakicat muslimane/Pirja e alkoolit për ilaç/ Përdorimi i ndyrësirave për ilaç/Përdorimi i ndyrësirave në ushqime/Përdorimi i xhelatinës/Dhënia dhe marrja e selamit nga jobesimtarët/Blerja e shtëpive në Perëndim përmes bankave/Të punuarit në banka/ Agjërimi në vendet ku nuk perëndon dielli fare.

Java e XV-të

Disa çështje (mesele) bashkëkohore të nevojshme për pakicat muslimane/Të punuarit në lokale të përziera me hallall e haram/Bashkimi i namazeve në shtëpi/Falja e xhumasë para kohe/Agjërimi në vendet ku dita është shumë e gjatë/(Mos) agjërimi për shkak të punëve të rënda/Urimi i festave jomuslimanëve/ Martesat për letra në perëndim.

Kriteri dhe komponentet e vlerësimit:

Angazhimi në ligjëratë: 10%

Pjesëmarrja në ligjëratë: 10%

Kollekfiumi i parë: 30 %

Kollekfiumi i dytë: 30 %

Punimi i seminarit: 20 %

Totali: 100 %.

Literatura themelore-obliguese:

1. Fik-hu i Pakicave Muslimane , (*Sfidat e muslimanëve në perëndim*) Shefqet Krasniqi.
2. Fik-hu el-Ekalijat el-Muslime, dr. Jusuf Kardavi.

Literatura zgjedhore-opsionale:

1. El-Eshbah ve En-Nedhair Sujutiu
2. El-Eshbah ve En-Nedhair Ibnu Nuxhejm
3. El-Kavaid el-Kubra el-Iz-z bin Abduselam.
4. Muxhez Tarih Texhdid ed-Din Ebu el-E'ala el-Mevdudi.